

Informacion i pergjithshem

Karte nenkupton nje pajisje elektronike plastike e cila mbart ne te informacionin e kartembajtesit dhe me te kartembajtesi mund te urdheroje veprime me llogarine e tij.

PIN eshte numri sekret personal i identifikimit , i cili ben te mundur perdorimin e kartes. Ky kod eshte konfidencial dhe duhet te mbahet i tille nga kartembajtesi.

Cikel eshte periudha kohore qe veprimet, interesat dhe komisionet llogariten dhe i paraqiten kartembajtesit. Zakonisht cikli i kartes se kreditit eshte 1 muaj perjashtuar ne rastet e veçanta specifikuar ne pikat e meposhtme te kesaj kontrate. Ciklet e kartes se kreditit zakonisht perfaqesojne nje periudhe perdorimi te kartes nga data 1 e muajit deri ne daten e fundit te muajit, duke bere perjashtime ne dite kur data e fillimit te muajit bie ndesh ne fundjave.

Nxjerrja e llogarise mujore (Fature ose statement). Nxjerrja e llogarise mujore i rreferohet pasqyres permbledhese e te gjithë veprimtarise me karte ku perfshihen veprime, interesa, komisione etj pergjate nje cikli. Nxjerrja e llogarise mujore perben lindjen e detyrimeve te klientit te cilat duhet te paguhen sipas kushteve te kesaj kontrate dhe sipas dates se fundit te shfaqur ne fature.

Data e nxjerrjes se llogarise eshte data ne te cilen kartembajtesi informohet per detyrimet qe ka ndaj bankes. Banka rezervon te drejten e shtyrjes se nxjerrjes se llogarise dhe zgjatjen e ciklit ne me shume se nje muaj nga prerja e ciklit paraardhes deri ne daten 10 te muajit pasardhes. Ne keto raste cikli i kartes se kreditit perfshin nje kohe me te gjate sesa nje muaj.

Data e fundit e pageses nenkupton daten e fundit ne te cilen klienti eshte i detyruar te shlyeje detyrimin mujor te tij, minimalisht pagesen minimale.

Detyrimi mujor eshte shuma e veprimeve, komisioneve dhe interesave te lindur nga perdorimi i kartes gjate nje cikli ose te mbartura nga cikli i meparshem, dhe qe kartembajtesi eshte i detyruar t'ia shlyeje ne teresi bankes

Pagesa minimale eshte nje vlere fikse, pjese e detyrimit mujor qe duhet te shlyhet domosdoshmerisht ne daten e fundit te pageses.

Terminale ATM (Automatet Teller Machine) : Jane terminale te cilet pranojne perdorimin e kartave bankare me logon perkatese dhe te vlefshme duke mundesuar dhenien e fondeve cash perdoruesit te kartes. Disa nga funksionet e ATM jane si me poshte:

- Dhenie e kartmonedhave cash pas nje transkasioni te sukseshem
- Verifikim i balances
- Ndryshim PIN, etj.

Terminale POS (Point of Sale): Jane terminale te vendosura prane tregtareve te ndryshem (dyqane) dhe nepermjet tyre behet e mundur blerja e mallrave te ndryshem duke perdorur pikerisht karta bankare. Terminale POS jane te vendosura nga banka te ndryshme dhe lihen ne perdorim te dyqaneve kundrejt terminaleve ATM qe jane ne perdorim kryesisht ne menaxhim nga banka.

Banka Leshuese: quhet banka e cila ka pajisur klientet me nje karte debiti ose krediti

Banka Pranuese: quhet banka e cila ka ne posedim терминаlet ATM ose i le ne perdorim терминаlet POS paleve te treta sic jane tregtaret e mallrave ose sherbimeve. Banka pranuese nepermjet terminaleve ATM/POS pranon kartat e bankave leshuese.

Autorizim: Veprimi autorizimit nenkupton autorizimin nga banka leshuese e nje kerkese per transakcion, nisur nga terminale te ndryshem si ATM/POS te nje banke pranuese. Autorizimi mund te jete pozitiv ose negativ, i pjesshem ose i plote, ne vartesi te kerkeses per transakcion. Pershembull, nese nje autorizim per nje veprim terheqje ne ATM vjen me nje pergjigje negative atehere ne kete rast veprimi nuk eshte i sukseshem.

Transaksion me karte: Veprim ose transakcion me karte quhet nje veprim i cili iniciohet pas nje autorizimi te sukseshem. Zakonisht transakcioni niset nga banka leshuese ne fund te dites pasi mblidhen te gjitha autorizimet e sukseshme (ATM) ose mblidhen te gjitha faturat nga Terminali POS dhe behen rikoncilimet perkatese. Pasi transakcioni vjen ne banken leshuese, zakonisht pas nje dite pune, banka i ben te ditur klientit kete veprim ne permjet llogarise se kartes.

Ne rastet kur dyshohet mbi nje autorizim te sukseshem ose jo, banka leshuese mban te bllokuar shumen e autorizuar ne llogarine e klientit deri ne qartesimin e autorizimit nga banka leshuese. Shembull i kesaj mund te jete ne momentet kur nga pakujdesia tentohet te kryhet autorizim i njepasnjeshem 2 here nga shitesi i dyqanit. Ky autorizim qartesoheq ne momentin kur shitesi ben rikoncilimet perkatese dhe shikon qe per kete autorizim ka vetem nje fature. Gjate kesaj kohe kartembajtesi detyrimisht i ka te bllokuara keto fonde.

Limiti ditor: Limiti ditor i kartes se kredi tit perfaqeson shumen totale qe klienti mund te perdore brenda 24 oreve (per cdo dite te javes). Nese nje klient brenda nje dite arrin kete limit, cdo transakcion tjeter do te refuzohet dhe ne ditin tjeter serisht ka te drejte te perdore sa limiti ditor. Limiti ditor mund te vendoset vecmas per blerje dhe vecmas per terheqje nga терминаlet ATM.

Vendosja e Limiti ditor eshte nje kufizim qe kryhet per te minimizuar riskun ne rast keqperdorimi te kartes ne rast humbjeje, vjedhjeje ose edhe per arsye te kufizimit te buxhetit.

Karte Primare / Karte Shtese: Karte Primare quhet karta e pare e leshuar ne nje llogari te caktuar ndersa karta shtese eshte nje karte e dyte e lidhur me te njejten llogari. Te gjitha transakcionet qe kryhen nga keto dy karta kontabilizohen ne te njejten llogari. Nje kartembajtes i kartes kryesore mund te ofroje karte shtese personave te zgjedhur nga ai dhe nuk ka nje limit ne numrin e kartave shtese te leshuara.